REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, INFRASTRUKTURËS, TRANSPORTIT DHE MJEDISIT

Nr. 11677/4 **Prot.** **Lezhë, më** 14.7.**2026**

Lënda: Procesverbal

Mbajtur më 14.07.2026
Ora:11:00
Vendi: Biblioteka "At Gjergj Fishta", Lezhë

Më datë 14.07.2026, ora 11:00, në ambientet e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" u zhvillua dëgjesa publike për shqyrtimin e projekt-vendimit **"Për Miratimin e Rregullores për Administrimin dhe Funksionimin e Shërbimit Funeral në Bashkinë Lezhë"**.

Dëgjesa u drejtua nga:

- Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Ndue Luli;
- Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, z. Jurgen Marku.

Në dëgjesë morën pjesë përfaqësues të institucioneve, administratorë dhe përfaqësues të agjencive funerale, ndër të cilat "Fildana", "Zefi", "Suli", "Sterkaj", si dhe qytetarë e grupe të tjera interesi.Mbledhja u hap nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Ndue Luli, i cili paraqiti qëllimin e dëgjesës publike dhe rëndësinë e miratimit të rregullores së re për administrimin dhe funksionimin e shërbimit funeral në Bashkinë Lezhë.Më pas, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, z. Jurgen Marku, prezantoi përmbajtjen e projekt-rregullores. Gjatë prezantimit u theksua se rregullorja synon të vendosë rregulla të qarta për administrimin e varrezave publike, procedurat e varrimit dhe zhvarrimit, si dhe administrimin e hapësirave të varrezave.

Në mënyrë të veçantë u trajtuan problematikat e evidentuara ndër vite lidhur me shitjen dhe blerjen e varreve, duke theksuar se me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje nuk do të lejohet në asnjë rast shitblerja e tyre.

Gjithashtu u bë me dije se:

- do të krijohet dhe vihet në funksion regjistri i varrezave, ku do të regjistrohet çdo rast varrimi dhe zhvarrimi;
- procedurat e varrimeve dhe zhvarrimeve do të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të shëndetit publik;
- mirëmbajtja e varrezave publike do të realizohet nga Bashkia Lezhë;

- çdo monument, varr apo ndërtim që do të realizohet në varreza do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga Bashkia Lezhë;
- për çdo rast varrimi, familjarët do të paraqesin kërkesë pranë Bashkisë Lezhë dhe, pas miratimit të saj, do të kryejnë pagesën sipas tarifave të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë.

Pas prezantimit u zhvillua diskutimi me pjesëmarrësit.

Përfaqësuesi i njërës nga agjencitë funerale që ishin prezentë parashtruan këto çështje:

1. Nëse kërkesa për varrim duhet të paraqitet nga familjarët e të ndjerit apo nga agjencia funerale.
2. Gjendjen e varrezave të vjetra në lagjen "Nënë Tereza", të cilat sipas tij kanë nevojë për ndërhyrje dhe rehabilitim.
3. Nëse shërbimi i varrimit do të kryhet nga punonjësit e Bashkisë Lezhë.

Pyetjet morën përgjigje nga Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, i cili sqaroi se kërkesa për varrim do të paraqitet nga familjarët e të ndjerit ose përfaqësuesi i tyre ligjor. Shërbimi i varrimit do të vazhdojë të kryhet nga agjencitë funerale deri në plotësimin e kapaciteteve të nevojshme të Bashkisë Lezhë për ofrimin e këtij shërbimi.Lidhur me problematikën e varrezave në lagjen "Nënë Tereza", u sqarua se Bashkia Lezhë do të kryejë verifikimin në terren dhe do të shqyrtojë mundësitë për ndërhyrje dhe përmirësimin e gjendjes së tyre.Gjithashtu u sqarua se në njësitë administrative zbatimi i procedurave të përcaktuara në rregullore do të mbikëqyret nga administratorët e njësive administrative, në bashkëpunim me kryepleqtë e fshatrave.

Gjatë diskutimeve, pjesëmarrësit ngritën shqetësime edhe në lidhje me praktikën e deritanishme të shitblerjes së varreve nga persona të ndryshëm. Qytetarët shprehën shqetësimin se, për shkak të mungesës së një administrimi të unifikuar, kanë kryer pagesa ndaj personave privatë nga frika e mungesës së një vendvarrimi në momentet e nevojës.

Në përgjigje të këtyre shqetësimeve u sqarua se projekt-rregullorja parashikon ndalimin e plotë të çdo forme shitblerjeje të varreve. Në vijim, qytetarët do të paguajnë vetëm tarifat zyrtare të miratuara nga Këshilli Bashkiak, sipas Paketës Fiskale në fuqi, ndërsa administrimi i varrezave do të kryhet nga Bashkia Lezhë në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin përkatës.

Në përfundim të dëgjesës publike, pjesëmarrësit u njohën me përmbajtjen e projekt-rregullores dhe paraqitën komentet dhe pyetjet e tyre. Sugjerimet dhe vërejtjet e shprehura gjatë dëgjesës do të merren në konsideratë gjatë procedurës së mëtejshme të miratimit të projekt-vendimit.

Dëgjesa publike përfundoi në orën 12:10.

Drejtuesi i mbledhjes

Jurgen MARKU

Mbajtësi i procesverbalit

Klara NDOKA

Sekretarja e Këshillit Bashkiak

Florida ÇUNAJ





